



SBASHK Arsimimi sot

Shkurt, 2024

Gazeta elektronike

Konferenca “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës” Vlerësim i lartë për organizimin e kësaj ngjarje të veçantë për arsimin



Pas angazhimit të përkushtuar të drejtuesve dhe stafit të Qendrës Amerikane të Solidaritetit dhe të SBASHK-ut, u mbajt Konferenca dyditore “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”. Për të marrë pjesë në këtë ngjarje të veçantë e në shenjë respekti për gjithë angazhimet e SBASHK-ut kishte ardhur nga Uashingtoni drejtorja ekzekutive e Qendrës Shauna Bader-Blau bashkë me drejtorin për programe të kësaj Qendre për Evropën dhe Azinë Qendrore Rudy Porter. Në konferencë për dy ditë kanë dhënë kontribut me vlerë edhe përfaqësues të institucioneve, të DKA-ve, të Departamentit të psikologjisë, përfaqësues të nxënësve, të medieve dhe veprimtarë sindikalë...(faqe 4)

Një mysafire e veçantë në SBASHK Drejtorja ekzekutive Bader-Blau shpreh respekt për angazhimet e sindikatës sonë



Drejtorja ekzekutive e Qendrës ...(faqe 5)

SBASHK në takime me
përfaqësuesit e Grupeve
Parlamentare

Alarm për ndryshimet e dëmshme që po bëhen në skemat pensionale



Për të shprehur ...(faqe 6)

Bisedë me koordinatorin për
organizim të brendshëm Ymer
Ymeri

Dëshmuam se dimë të organizojmë veprimtari domethënëse për arsimin



SBASHK duke vazhduar ...(faqe 3)

SBASHK memorandum bashkëpunimi me Poliklinikën dhe laboratorin
Bio analiza

Zbritje deri në 20% për shërbimet në këtë institucion shëndetësor



Duke shprehur respektin ...(faqe 5)



Editorial

Muaji i kujtesës për dëshmorët e kombit dhe pishtarët e dijes



Nëpër vite e dekada fillimet e marsit janë momente krenarie për kombin tonë. Shqiptarët kudo janë, lartësojnë kujtimin për dëshmorët e kombit duke marrë pjesë në aktivitetet e shumta në kuadër të Epopesë së UÇK-së. Më 5, 6 e 7 mars Prekazi është vendtakimi për gjeneratat. Ata i bashkohen vargut të poetit dhe shpalosin bashkë faqet e ndritura të historisë së kombit tonë duke përmendur Komandantin Adem Jashari dhe gjithë dëshmorët e heronjtë e kombit që i sollën lirinë atdheut. Në fillimet e marsit është edhe një datë e shënuar e kombit

tonë. Punëtorët e arsimit me aktivitete të shumta kujtojnë pishtarët e dijes dhe rrugëtimin që nisi më 7 mars në Korçë për të vazhduar për jetë e mot. SBASHK-u edhe këtë vit ka filluar përgatitjet me kohë për të shënuar ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe. Stafi qendror në bashkëpunim me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve ka përgatitur mirënjohje për kolegët e pensionuar dhe do të organizohen takime solemne me ta në gjithë komunat e Kosovës dhe në Universitete. Urime dita e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Bisedë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Dëshmuam se dimë të organizojmë veprimtari domethënëse për arsimin



SBASHK duke vazhduar bashkëpunimin me Qendrën Amerikane të Solidaritetit arriti të organizojë Konferencën dyditore “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”. Kjo ngjarje që bëri bashkë palët që ndërlidhen me arsimin u vlerësua lart nga pjesëmarrësit mes të cilëve ishin edhe drejtorja ekzekutive e Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Uashington Shauna Bader-Blau dhe drejtori i programit rajonal të Qendrës për Evropën dhe Azinë Qendrore Rudy Porter.

Për këtë aktivitet dhe për angazhimet tjera të SBASHK-ut për këtë numër të gazetës sonë biseduam me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Ai fillimisht tregoi se ishte goxha sfiduese përgatitja e një ngjarje të tillë dhe prandaj përgatitjet kishin nisur që nga dhjetori i vitit të kaluar përmes një tryeze të organizuar me të gjitha palët që ndërlidhen me arsimin e pastaj është

vazhduar me takime e konsulta të përditshme mes stafit të SBASHK-ut dhe të Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë. Bisedohej për çdo detaj dhe ishte qëndrim i të dy palëve që të vazhdohet me angazhimin e përkushtimin me dëshirën e vetme që kjo ngjarje të jetë e organizuar në nivel të lartë dhe të arrijë objektivat e saj. Ymeri tani flet me mburrje duke thënë se SBASHK-u edhe një herë u dëshmuua se di të organizojë aktivitete të shumta sindikale, por edhe veprimtari domethënëse për arsim. Ai shpreh respekt të lartë për të gjithë pjesëmarrësit, që kanë dhënë kontribut me vlerë në rrjedhën e mbarë të Konferencës dhe në nxjerrjen e përfundimeve e detyrave konkrete që duhen bërë në të ardhmen.

Koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK po ashtu tregon se kanë nisur me kohë përgatitjet edhe për shënimin e ditës së mësuesit e shkollës shqipe duke përmendur komunikimin e vazhdueshëm me kryetarët e nivelit komunal e të universiteteve dhe përkushtimin e stafit qendror në mënyrë që kjo festë e madhe të shënohet duke shprehur respekt meritore për koleget e kolegët e pensionuar nga prilli i vitit të kaluar e deri tani, por edhe për gjithë pishtarët e dijes, që nëpër vite e dekada kanë kryer misionin e shenjtë për arsimimin dhe edukimin e brezave.

Koordinatori Ymeri tregon se angazhimet nuk kanë të ndalur sepse do të vazhdohet me takimet nëpër komuna për të bashkëbiseduar me veprimtarët sindikalë e po ashtu do të niset me përgatitjet edhe për aktivitetin tradicional të pushimeve të një numri të konsideruar të anëtareve e anëtarëve të SBASHK-ut në bregdetin shqiptar. Ai tregon se këto janë vetëm disa nga aktivitetet në SBASHK duke u shprehur se do të vazhdohen angazhimet e shumta në shërbim të anëtarësisë dhe në shërbim të arsimit në Kosovë.

Gjatë muajit

Konferenca “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”

Vlerësim i lartë për organizimin e kësaj ngjarje të veçantë për arsimin

Pas angazhimit të përkushtuar të drejtuesve dhe stafit të Qendrës Amerikane të Solidaritetit dhe të SBASHK-ut, u mbajt Konferenca dyditore “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”.



Për të marrë pjesë në këtë ngjarje të veçantë e në shenjë respekti për gjithë angazhimet e SBASHK-ut kishte ardhur nga Uashingtoni drejtorja ekzekutive e Qendrës Shauna Bader-Blau bashkë me drejtorin për programe të kësaj Qendre për Evropën dhe Azinë Qendrore Rudy Porter. Në



konferencë për dy ditë kanë dhënë kontribut me vlerë edhe përfaqësues të institucioneve, të DKA-ve, të Departamentit të psikologjisë, përfaqësues të nxënësve, të medieve dhe veprimtarë sindikalë.

Pjesëmarrësve të Konferencës u është drejtuar me një video mesazh drejtoresha ekzekutive e Unionit të Sindikatave të Evropës (ETUCE), Suzan Flocken, e cila ka përgëzuar SBASHK-un për gjithë angazhimet dhe për organizimin me sukses të kësaj ngjarje të veçantë për arsimin në Kosovë duke u shprehur se angazhimet e shumta i kanë pamundësuar që të jetë në këtë Konferencë.

Të gjithë janë angazhuar maksimalisht për rrjedhën e mbarë të kësaj ngjarje të veçantë, e cila u vlerësua lartë



dhe pjesëmarrësit përgëzuan SBASHK-un dhe Qendrën Amerikane të Solidaritetit për angazhimin dhe për organizimin kaq të mirë.



Gjatë konferencës përmes paneleve është diskutuar dhe janë bërë analiza e janë dhënë konkluzione lidhur me gjendjen aktuale të shëndetit mendor në shkollat e Kosovës, për ndjeshmërinë kulturore në edukimin e shëndetit mendor, për përgatitjen dhe mbështetjen e mësuesve për këto aktivitete, për krijimin e mjedisve të sigurtë e gjithëpërfshirëse, për integrimin e shëndetit mendor në programet mësimore, për qasjet në burimet ekzistuese të shëndetit mendor, puna me SBASHK, mësuesit, të rinjtë, psikologët, prindërit dhe komunitetin, promovimi i shëndetit mendor nëpërmjet përpjekjeve avokuese që synojnë Ministrinë e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë, roli i palëve të ndryshme në mbështetje të kujdesit mendor në shkollë, vështirësitë që hasin mësuesit lidhur me shëndetin mendor e tema të tjera që janë shpalosur gjatë dy ditëve të Konferencës.



SBASHK-u shpreh respekt për znj. Bader-Blau, për z.Porter, për z.Steven e stafin e zyrës në Tiranë dhe për të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës të cilët me prezantime e me diskutime i dhanë vlerë këtij aktiviteti dhe nxorën konkluzione që do t'i dërgohen institucioneve të Kosovës.



Më shumë se me fjalë atmosferën nga punimet e kësaj Konference po e përcjellim të ju lexues të nderuar me disa foto, ndërsa shumë prej tyre do t'i ruajmë në shenjë kujtimi për dy ditët plot gjallëri e përkushtim të pjesëmarrësve në

këtë ngjarje në shërbim të arsimit në Kosovë.

SBASHK-u falënderon për kontributin e dhënë gjithë pjesëmarrësit e në veçanti znj.Bader-Blau, z.Porter, mysafirët nga sindikatat simotra të Sllovenisë, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe ata që dhanë kontribut të lartë



në debate gjatë paneleve e sesioneve paralele duke nxjerr konkluzione që do t'i dërgohen institucioneve të Kosovës.

Një mysafire e veçantë në SBASHK

Drejtorja ekzekutive Bader-Blau shpreh respekt për angazhimet e sindikatës sonë



Drejtorja ekzekutive e Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Uashington ka ardhur në Kosovë për të marrë pjesë në Konferencën “Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës”,

që u organizua nga SBASHK dhe Qendra Amerikane e Solidaritetit me seli në Tiranë. Para nisjes së Konferencës ajo ka zhvilluar takime me kryetarin Jasharaj dhe me stafin e SBASHK-ut duke i përgëzuar për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit në Kosovë e duke cekur se Qendra Amerikane e Solidaritetit do të mbështes edhe në të ardhmen SBASHK-un në aktivitetet e radhës.

Zonja Bader-Blau ka kujtuar edhe intervistën që kishte

zhvilluar me kryetarin Jasharaj duke vlerësuar lart përgjigjet e tij dhe pasqyrimin e saktë të gjendjes së arsimit dhe për angazhimet e vazhdueshme të SBASHK-ut në shërbim të kërkesave të anëtarësisë dhe forcimit të zërit sindikal. Në një bashkëbisedë miqësore kryetari Jasharaj dhe nënkryetarja Vjollca Shala e koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri e kanë informuar mysafiren e nderuar edhe për bashkëpunimin domethënës me Qendrën Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë duke shprehur respekt meritore për drejtorin e kësaj zyre Steven McClaud dhe Brunën e Kejsin. Kryetari i SBASHK-ut është shprehur se për këtë bashkëpunim dhe arritjet e përbashkëta janë meritore Steven, stafi i tij dhe stafi i SBASHK-ut Vjollca, Ymeri, Afërdita, Vlora, Blendori, Albina e Nezafetja, por edhe kryetarët e nivelit komunal sindikal, të universiteteve, por edhe shumë veprimtarë sindikalë nga e tërë Kosova.

SBASHK memorandum bashkëpunimi me Poliklinikën dhe laboratorin Bio analiza Zbritje deri në 20% për shërbimet në këtë institucion shëndetësor



Duke shprehur respektin për punëtorët arsimorë, përfaqësuesit e Poliklinikës dhe laboratorit “Bioanaliza 1 dhe 2” Arbër Murseli dhe Muhadin Murseli

kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me SBASHK-un që është përfaqësuar nga kryetari i Kuvendit të Arsimit Parauniversitar për komunën e Vitisë, Kemajl Bislimi dhe veprimtari Ismet Mehmeti. Ky institucion shëndetësor gjendet në Rr. e Preshevës, nr. 115 në Viti. Memorandumi i bashkëpunimit saktëson se anëtarët e SBASHK-ut do të kenë zbritje prej 20% nga çmimi

ekzistues për analizat laboratorike, mikrobiologjike, shërbimet specialiste, ultrazë, EKG, rentgen (Grafit) dhe certifikata shëndetësore.

Pagesën e zbritjes prej 20 % anëtarët e SBASHK-ut e bëjnë me rastin e marrjes së shërbimeve të cekura në këtë


memorandum bashkëpunimi.

SBASHK falënderon Arbër Murseli dhe Muhadin Murseli për respektin e treguar për punëtorët arsimorë dhe për zbritjen e ofruar për anëtarët e SBASHK-ut për shërbimet që kryhen në këtë institucion privat shëndetësor.

SBASHK në takime me përfaqësuesit e Grupeve Parlamentare

Alarm për ndryshimet e dëmshme që po bëhen në skemat pensionale

Për të shprehur shqetësimet lidhur me ndryshimet që janë bërë në skemën pensionale që kanë prekur në të drejtat e fituara të punëtorëve të pensionuar arsimor, përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar fillimisht me kryetarin e Komisionit parlamentar për arsim, Ardian Gola e pastaj me shefin e Grupit parlamentar të PDK-së, Abelard Tahiri, me përfaqësuesin e Grupit parlamentar të LDK-së, Driton Selmanaj dhe shefin e grupit parlamentar të AAK-së Besnik Tahiri.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri në takime të ndara u kanë ofruar argumente, të cilat ua kanë lënë edhe në formë të shkruar, z.Abelard Tahirit, z.Driton Selmanajt e

z.Besnik Tahirit duke i lutur që të analizojnë këto fakte dhe të nisin iniciativën për të dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese dhe për të nisur debat në Parlament në mënyrë që të evitohen lëshimet në ndryshimet e bëra në Ligjin për skemën pensionale të financuar nga shteti dhe t'u kthehet e drejta e fituar punëtorëve të pensionuar nga arsimi.


Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar edhe me Avokatin e popullit duke ia prezantuar këto shqetësime edhe në formë të shkruar. SBASHK pret që të kenë takime edhe me shefen e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes Mimoza Kusari-Lila dhe të Grupit Parlamentar Multietnik Enis Kervan.



SBASHK në takim me avokatin e popullit U prezantuan kërkesa konkrete



Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës
Institucija Ombudsmana Republike Kosova
Ombudsperson institution of Republic of Kosovo



Kërkesat e SBASHK-ut sa i përket Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti janë këto:

I. Të largohet nga Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti çdo dispozitë e cila i referohet Ligjit të ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK), të Serbisë ose të ish Jugosllavisë.

Arsyetim:

Skemat pensionale të financuara nga shteti paguhen nga buxheti i Republikës së Kosovës e jo nga fondi kontributëdhënës i ish Krahinës Socialiste Autonome të

Kosovës (KSAK), i cili fond është grabitur dhe shndërruar në fond pensional të Serbisë ku edhe sot e kësaj dite ky fond pensional është i grabitur dhe nën menaxhim të Serbisë. Prandaj ne mendojmë se është fare e pa nevojshme që Republika e Kosovës t'i referohet Ligjeve të KSAK-së, të Serbisë ose të ish Jugosllavisë.

II. Të kthehet pika 6 e nenit 8 të ligjit bazik për skemat pensionale të financuara nga shteti, e cila është larguar me plotësim ndryshimin e ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti më datën 16.08.2023, në të cilën pikë thuhet: “ Neni 8 pika 6 Me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës” Pikës t'i shtohet edhe “ të punësuarve të cilët janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme”

Arsyetim:

Për shkak se me largimin e pikës 6 të nenit 8 ju është mohuar puna të punësuarve të cilët gjatë viteve 1990

deri më 1999 kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës ose janë dëbuar dhunshëm nga vendet e tyre të punës dhe janë favorizuar ata të cilët kanë punuar me sistemin e Serbisë dhe kanë paguar kontributet pensionale në fondin e pensioneve të Serbisë. Pra, aktualisht pagesë për vitet 1989-1999 ju bëhet vetëm atyre që në këto vite i kanë shërbyer Serbisë, ndërsa të punësuarve në sistemin e Republikës së Kosovës dhe të punësuarve që janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme u njihen vetëm për ta plotësuar kushtin prej 15 viteve por nuk ju paguhet fare kjo periudhë.

III. Pagesa e pensionit kontributdhënës duhet të bëhet deri më 01.07.2002 deri atëherë kur ka filluar të funksionoj Fondi për kursimet pensionale të Kosovës TRUST, e jo deri më 01.01.1999.

Arsyetim:

Të punësuarit në sistemin e Arsimit të Republikës së Kosovës kanë punuar pa shpërblyerje edhe në vitin shkollor 1998/99 me nxënësit kosovar të shpërngulur në Shqipëri, Maqedoni dhe Mal të Zi dhe pas kthimit në Kosovë ky vit shkollor ka vazhduar deri më datën 31.10.1999, duke vazhduar të punojnë pa ndërprerje deri në kohën kur janë pensionuar, andaj periudha kohore nga viti 01.01.1999 deri me 01.07.2002 mbetet periudhë e pa mbuluar as me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti e as

me Ligjin për fondin e kursimeve pensionale të Kosovës TRUST. Në bazë të kësaj ne mendojmë se kjo periudhë kohore duhet ti bashkohet pensionit kontributdhënës.

IV. Të njihen diplomat e kualifikimit për të gjithë të punësuarit në sistemin e arsimit deri në momentin e pensionimit e jo vetëm deri në vitin 1989 siç njihen tani.

Arsyetim:

Mos njohja e diplomave të kualifikimit të cilat janë lëshuar gjatë periudhës së sistemit të Republikës të Kosovës është një padrejtësi që ju bëhet të punësuarve që kanë kontribuar në atë kohë të artë për Kosovën dhe jep indikacione të mos njohjes së sistemit të Arsimit të Republikës së Kosovës të kësaj periudhe.

Këto kërkesa të SBASHK-ut, janë në harmoni të plotë me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese më nr. SGJ2112/23 të datës 16.01.2023 për Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve si dhe me Konventën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e cila garanton që një e drejtë e fituar nuk mund të mohohet.

Shumë marrëveshje mirëkuptimi në shërbim të anëtarësisë Zbritje çmimesh që ndihmojnë buxhetin familjar

Krahas aktiviteteve të shumta SBASHK-u ka arritur të nënshkruaj edhe më shumë se 100 marrëveshje mirëkuptimi me institucione private shëndetësore, me institucione për pushim e rekreacion dhe me qendra të ndryshme tregtare. Këto marrëveshje janë arritur duke u bazuar në respektin meritore që kanë pronarët dhe personeli për punëtorët e arsimit dhe për kontributin e tyre për arsimimin dhe edukimin e brezave nëpër vite e dekada. Këto marrëveshje saktësojnë se anëtarët e SBASHK-ut gëzojnë zbritje të caktuara çmimesh për gjërat e blera, apo për shërbimet

e kryera shëndetësore e që janë një ndihmë modeste për buxhetin familjar.

SBASHK-u apelon te anëtarësia që të shfrytëzojnë këto mundësi duke filluar nga Banja e njohur “Nëna Naile”, institucionet private shëndetësore, barnatoret, Poliklinikat, laboratorët, “Optika Moda” e institucione të tjera me të cilat kemi nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi. SBASHK do të vazhdojë nënshkrimin e marrëveshjeve të tilla në shërbim të anëtarësisë.

The screenshot displays the official website of the Union of Education, Science and Culture (SBASHK). The header features the organization's logo and name in both Albanian and English. A navigation menu includes links to Home, About Us, SBASHK, Organization, Finance and Membership, News, and Projects. The main content area is titled 'Adresa' (Address) and provides the following details: Rr. Agim Ramadani p.n, Qendra e Studentëve - Drejtoria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, and contact numbers for phone and email. To the right, a sidebar lists various services offered by member organizations, such as medical services, technical equipment, and recreational activities. A date stamp indicates the information is from January 22, 2021.